Vendim nr. 323, datë 12.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 12.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (V) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE:	**VALENTINA TEODORESKU**
OBJEKTI:	**Shfuqizimi i vendimit nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 56, datë 13.05.2010, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1793, datë 22.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1458, datë 19.06.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-1764, datë 11.04.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
BAZA LIGJORE:	**Nenet 41, 42, 131, pika 1 shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është një ndër trashëgimtarët e trashëgimlënësit A.Sh., me kërkesën e të cilit Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Tepelenë *(KKKP),* bazuar në ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me vendimin nr. 241, datë 29.12.1995, ka vendosur t'i njohë atij pronësinë për truallin me sipërfaqe 1.152 m^2 në fshatin Dragot, Tepelenë, si dhe kompensimin për këtë sipërfaqe, pasi ajo ishte e zënë me ndërtime të përhershme, konkretisht një banesë shtetërore, e cila më parë kishte shërbyer si kopsht dhe çerdhe e fshatit.

2. Vendimi i KKKP-së është kundërshtuar në gjykatë nga A.Sh., për sa i përket disponimit për kompensimin e pronës, duke kërkuar anulimin e tij dhe kthimin e pronës. Në këtë proces kanë marrë pjesë si të paditur shtetasit R.M. dhe R.I. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjirokastër, me vendimin nr. 485, datë 16.07.1999, ka vendosur anulimin e pjesshëm të vendimit të KKKP-së dhe kthimin në favor të A.Sh. të sipërfaqes 819 m^2, nga sipërfaqja totale që i ishte njohur atij. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në sipërfaqen për të cilën A.Sh. i ishte njohur pronësia ndodhej një godinë, por se ndryshe nga sa pretendonte ai, godina ishte ndërtuar tërësisht nga shteti dhe në vitin 1982 ajo u ishte dhënë me qira R.M. dhe R.I, të cilët kanë paguar rregullisht qiranë. Për këtë shkak, sipas gjykatës, godina dhe trualli funksional i saj nuk mund t'i ktheheshin në natyrë A.Sh., sikurse kishte vendosur edhe KKKP-ja. Për sa i përket sipërfaqes funksionale të godinës, tashmë të shndërruar në banesë, gjykata, bazuar në aktin e ekspertimit të administruar në gjykim, ka pranuar se ajo ishte 317 m^2. Mbi këtë bazë, gjykata ka vendosur kthimin në favor të A.Sh. të sipërfaqes së mbetur prej 819 m^2. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 451, datë 15.12.1999, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1205, datë 22.11.2000, ka vendosur mospranimin e rekursit të A.Sh.

3. Nga ana tjetër, shtetasit R.M. dhe R.I., në cilësinë e anëtarëve të kooperativës bujqësore, bazuar në vendimin nr. 266, datë 08.08.1991 të Këshillit të Ministrave "Për ndarjen e pasurisë së kooperativave bujqësore", kanë blerë banesën ku jetonin me qira, përmes kontratave të shitjes që janë finalizuar në 1998, nga komuna Qendër Tepelenë, së cilës, në vitin 1993, i kishin kaluar në administrim ish-objektet e kooperativës bujqësore.

4. Kontrata e shitjes në favor të R.M. është kundërshtuar me padi nga babai i kërkueses, A.Sh., por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tepelenë, me vendimin nr. 00254, datë 25.09.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj. Sipas gjykatës, kontrata plotësonte kushtet ligjore të vlefshmërisë të përcaktuara në nenin 663 të Kodit Civil. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 15, datë 17.01.2002. Sipas gjykatës së apelit, ish-objektet e kooperativave bujqësore privatizoheshin në favor të ish-anëtarëve të tyre mbi bazën e vendimeve të komisioneve përkatëse, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës. Në rastin konkret, ajo gjykatë ka arsyetuar se objekti ish-çerdhe e shndërruar në banesë, me sipërfaqe 32 m², ishte shitur së bashku me truallin funksional që zinte ai, veprim i cili nuk ndalohej nga asnjë dispozitë ligjore ose nënligjore. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1369, datë 27.12.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit të babait të kërkueses.

5. Në një procedurë të veçantë gjyqësore, kërkuesja, në cilësinë e trashëgimtares ligjore, në datën 07.03.2017 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e tri vendimeve gjyqësore të përmendura në paragrafin 4 të këtij vendimi. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4033, datë 12.11.2025, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me argumentin se nuk plotësoheshin kriteret e përcaktuara nga neni 494, shkronja "a", i Kodit të Procedurës Civile. Në vijim, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual kundër vendimit të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 209, datë 25.06.2026, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar si haptazi të pabazuar pretendimin e kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

6. Nga ana tjetër, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tepelenë *(ZVRPP-ja, Tepelenë)* ka regjistruar në pronësi të R.I. pasurinë "truall" me sipërfaqe 300 m², nga të cilat 20 m² ndërtesë, duke e pajisur me certifikatë pronësie në datën 02.12.2002. Po ashtu, ajo ka regjistruar në pronësi të R.M. pasurinë "truall" me sipërfaqe 300 m², nga të cilat 40 m² ndërtesë, duke e pajisur me certifikatë pronësie në datën 02.06.2004.

7. Ndërkohë, me kërkesë të A.Sh., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 182, datë 26.11.2004, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e saj të formës së prerë nr. 485, datë 16.07.1999 *(shih paragrafin 2 të vendimit).* Në vijim, A.Sh. ka vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, në kuadër të së cilës zyra e përmbarimit i ka kërkuar ZVRPP-së, Tepelenë regjistrimin në pronësi të A.Sh. të truallit me sipërfaqe 819 m^2. ZVRPP-ja, Tepelenë, pas verifikimeve, ka konstatuar se trualli i kërkuar për regjistrim mbivendosej me truallin e regjistruar në pronësi të R.M. dhe R.I. Për këtë shkak,

duke vlerësuar se regjistrimet në favor të këtyre shtetasve ishin kryer në shkelje të ligjit, ZVRPP-ja, Tepelenë i ka kërkuar kryeregjistruesit fshirjen e tyre. Me vendimin nr. 26, datë 03.07.2008, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme *(ZQRPP) (vendimi nr. 26/2008),* bazuar në nenin 10 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar *(ligji nr. 7843/1994),* dhe në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007 "Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme" *(udhëzimi nr. 4/2007),* ka vendosur fshirjen e regjistrimeve në favor të shtetasve R.M. dhe R.I.

8. Në datën 10.10.2008 shtetasit R.M. dhe R.I. i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar anulimin tërësisht të vendimit nr. 26/2008 të kryeregjistruesit. Në gjykim kanë marrë pjesë, në cilësinë e ndërhyrësve dytësorë, trashëgimtarët e A.Sh., ndër ta edhe kërkuesja. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1771, datë 09.03.2011, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 26/2008 të kryeregjistruesit. Ky vendim është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 481, datë 06.03.2012. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1793, datë 22.02.2013, ka vendosur pranimin e padisë dhe anulimin e vendimit nr. 26/2008 të kryeregjistruesit. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe trashëgimtarët e A.Sh., ndër ta edhe kërkuesja.

9. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2232, datë 20.05.2014, ka deklaruar moskompetencën lëndore dhe ia ka dërguar çështjen Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 1458, datë 19.06.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1793, datë 22.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rekursin e trashëgimtarëve të A.Sh., të përfaqësuar nga kërkuesja, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1764, datë 11.04.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi haptazi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012).*

10. Në një proces tjetër civil, trashëgimtarët e A.Sh., ndër ta edhe kërkuesja, kanë ngritur padi kundër shtetasve R.M. dhe R.I., si dhe disa subjekteve publike, me objekt shpërblimin e dëmit, fitimin e munguar, pushimin e cenimit të pronësisë dhe kthimin në posedim të sendit. Nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se

rekursi në këtë çështje është regjistruar në datën 21.03.2017, me nr. 11243-00909-00-2017, dhe statusi i saj është “në proces”.

11. Në datën 28.05.2026 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 25.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkueses

12. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor,* në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi gjyqtarët e gjykatave të zakonshme nuk i kanë shqyrtuar dhe vlerësuar siç duhet dokumentet e paraqitura gjatë gjykimit, duke krijuar dyshime për paanshmërinë e tyre në trajtimin e çështjes. Në këtë drejtim, gjykatat nuk kanë marrë parasysh edhe pretendimin se data e shënuar në zarfin e njoftimit të vendimit të kryeregjistruesit palës paditëse ishte falsifikuar, çka tregonte se padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.

12.1.2. *Së drejtës së aksesit në gjykatë* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi çështja nuk duhej të ishte shqyrtuar në themel, për shkak se padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor dhe nga persona që nuk legjitimoheshin për ngritjen e saj. Gjykatat e zakonshme duhet të kishin vendosur pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes së vlefshmërisë së titujve të pronësisë dhe regjistrimit të tyre. Po ashtu, në rigjykimin e çështjes nuk janë respektuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 481, datë 06.03.2012, lidhur me objektin e padisë, ndërsa gjykata e shkallës së parë e ka trajtuar mosmarrëveshjen si çështje të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, megjithëse ishte kërkuar anulimi i tij. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë analizuar siç duhet dokumentacionin e regjistrimit të pasurisë, kontratat dhe dokumentet mbi të cilat është mbështetur kalimi ose regjistrimi i pronësisë.

12.2. *E drejta e pronës,* pasi pasuria objekt i mosmarrëveshjes është regjistruar dhe disponuar në favor të personave të tjerë mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara ose që nuk përbëjnë tituj të vlefshëm pronësie. Objektet janë ndërtuar nga trashëgimlënësi i kërkueses, ndërsa regjistrimet e mëvonshme në favor të personave të tjerë janë kryer në mënyrë të paligjshme. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të vendosë rikthimin e kompetencave të kryeregjistruesit për fshirjen e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme, të shfuqizuara me vendimin e saj nr. 17, datë 23.04.2010 *(vendimi nr. 17/2010),* duke rivendosur të drejtën e trashëgimlënësit A.Sh., babait të kërkueses, pasi pala paditëse e ka disponuar pronën në mënyrë të paligjshme.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

13. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave edhe kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre për të vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mbi këtë bazë, Kolegji do të ndalet në vijim në vlerësimin e natyrës kushtetuese të pretendimeve të kërkueses dhe, për ato që përfshihen në juridiksionin kushtetues, në bazueshmërinë e tyre për qëllime të shqyrtimit paraprak.

15. Kolegji vëren se, megjithëse pretendimet e kërkueses nuk janë strukturuar qartësisht në ankimin kushtetues individual, nga përmbajtja dhe thelbi i tyre rezulton se ajo ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* të *së drejtës së*

aksesit në gjykatë dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe të *së drejtës së pronës.*

16. Për pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* kërkuesja ka argumentuar se gjykatat e zakonshme nuk i kanë shqyrtuar dhe vlerësuar siç duhet dokumentet e paraqitura gjatë gjykimit, duke krijuar dyshime për paanshmërinë e tyre në trajtimin e çështjes. Kolegji vëren se kërkuesja nuk ka parashtruar fakte ose rrethana konkrete që të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve që kanë shqyrtuar çështjen e saj, qoftë në aspektin subjektiv, qoftë në atë objektiv. Argumentet e parashtruara prej saj lidhen me mënyrën e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme, si dhe me përfundimet në të cilat ato kanë arritur. Edhe argumenti për falsifikimin e pretenduar të datës së shënuar në zarfin e njoftimit të vendimit të kryeregjistruesit lidhet me vlerësimin e provave dhe nuk përbën tregues të mungesës së paanshmërisë së gjyqtarëve. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe përcaktimi i rrethanave faktike janë, si rregull, detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa kontrolli kushtetues kufizohet në verifikimin nëse procesi gjyqësor ka respektuar të drejtat dhe garancitë kushtetuese të individit *(shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, në mungesë të argumenteve konkrete që të mbështesin dyshime objektivisht të justifikueshme për paanshmërinë e gjykatës, Kolegji çmon se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Kolegji vëren se në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuesja ka kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit nr. 17/2010 të Gjykatës, me të cilin, mbi kërkesën e Avokatit të Popullit, janë shfuqizuar paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 10 të ligjit nr. 7843/1994 dhe udhëzimi nr. 4/2007, që parashikonin kompetencën e kryeregjistruesit për fshirjen e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme në rast mbivendosjeje. Sipas kërkueses, shfuqizimi i dispozitave që parashikonin këtë kompetencë ka ndikuar në cenimin e së drejtës së saj të pronës. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se, sipas nenit 132, pika 1, të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Duke qenë se Kushtetuta dhe ligji organik nuk parashikojnë kompetencën e Gjykatës për të shqyrtuar, nëpërmjet ankimit kushtetues individual, kërkime për shfuqizimin e vendimeve të saj përfundimtare, Kolegji çmon se ky kërkim nuk hyn në kompetencën e saj. Megjithatë, për aq sa argumentet e kërkueses lidhen me mënyrën e zbatimit të vendimit nr. 17/2010 nga gjykatat e zakonshme, ato do të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të pretendimeve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës së pronës.

18. Për pretendimin për cenimin e *së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkuesja ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë shqyrtuar në themel padinë, ndonëse ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor dhe nga persona që, sipas saj, nuk legjitimoheshin për ngritjen e saj. Ajo ka kundërshtuar, gjithashtu, mënyrën e vlerësimit të dokumentacionit të pronësisë, duke pretenduar se regjistrimet në favor të personave të tjerë janë mbështetur në dokumente të falsifikuara ose në akte që nuk përbëjnë tituj të vlefshëm pronësie. Sipas kërkueses, gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje të mjaftueshme këtyre pretendimeve, duke cenuar të drejtën e saj për proces të rregullt ligjor dhe të drejtën e pronës.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, pasi shkalla e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë dhe rrethanat konkrete të çështjes (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata në jurisprudencën e saj në mënyrë konstante ka pohuar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve, janë çështje që, si rregull, i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Mënyra se si këto gjykata kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi ka cenuar të drejtat kushtetuese të individit, duke e bërë procesin gjyqësor, në tërësinë e tij, haptazi të paarsyeshëm ose arbitrar, në kundërshtim me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja ka pasur për objekt anulimin e vendimit nr. 26/2008 të kryeregjistruesit, me të cilin ishte urdhëruar fshirja e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme në favor të shtetasve R.M. dhe

R.I., për shkak të mbivendosjes së tyre me pasurinë për të cilën trashëgimlënësit të kërkueses i ishte njohur e drejta e pronësisë. Padia për kundërshtimin e këtij vendimi është paraqitur në datën 10.10.2008. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar padinë, duke vendosur anulimin e vendimit të kryeregjistruesit dhe duke arsyetuar se ky akt ishte absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të nenit 116, shkronja "b", të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" *(KPA),* pasi ishte nxjerrë në kapërcim të kompetencave të organit administrativ. Në arsyetimin e saj gjykata i është referuar edhe vendimit nr. 17/2010 të Gjykatës, me të cilin janë shfuqizuar dispozitat ligjore dhe akti nënligjor që parashikonin kompetencën e kryeregjistruesit për fshirjen e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme në rast mbivendosjeje. Duke iu referuar nenit 76 të Ligjit Organik të Gjykatës, gjykata ka vlerësuar se efektet e vendimit nr. 17/2010 shtriheshin edhe mbi çështjen konkrete, për shkak se procesi gjyqësor i nisur në datën 10.10.2008 ishte ende në shqyrtim në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

22. Çështja është shqyrtuar në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, mbi ankimin edhe të ndërhyrësve dytësorë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi. Gjykata e apelit ka evidentuar se vendimi nr. 26/2008 i kryeregjistruesit u ishte njoftuar paditësve në datën 23.09.2008, ndërsa padia ishte paraqitur në datën 10.10.2008. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se vendimi i kryeregjistruesit ishte absolutisht i pavlefshëm për shkak të kapërcimit të kompetencave ligjore të këtij organi. Për këtë arsye, ajo nuk e ka konsideruar të nevojshëm shqyrtimin e pretendimeve të ndërhyrësve dytësorë lidhur me vlefshmërinë e titujve të pronësisë dhe ligjshmërinë e regjistrimeve të pasurive në favor të shtetasve R.M. dhe R.I.

23. Për rekursin e ndërhyrësve dytësorë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Në këtë drejtim, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se i takon rekursuesit të parashtrojë në mënyrë të qartë dhe të plotë shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Sipas Gjykatës së Lartë, nuk rezulton që Gjykata Administrative e Apelit të ketë zhvilluar një proces të parregullt ligjor ose të mos ketë garantuar hetimin e plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ndërsa pretendimet e tjera të rekursuesve lidhen me vlerësimin e provave.

24. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesja dhe trashëgimtarët e tjerë kanë marrë pjesë në procesin gjyqësor dhe kanë ushtruar mjetet e ankimit të parashikuara nga ligji, përfshirë rekursin në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, argumentet e kërkueses nuk lidhen me

pamundësinë për t'iu drejtuar gjykatës ose me pengimin e ushtrimit të mjeteve të ankimit, por, në thelb, me mënyrën se si gjykatat kanë zbatuar rregullat procedurale për pranueshmërinë e padisë dhe kanë vlerësuar pretendimet e saj. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se këto argumente duhet të vlerësohen kryesisht në kuadër të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të ndalimit të arbitraritetit në procesin gjyqësor, dhe jo si një pretendim i mëvetësishëm për mohim të aksesit në gjykatë.

25. Për sa i përket standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme e kanë shqyrtuar mosmarrëveshjen brenda kufijve të objektit të padisë, duke u shprehur për ligjshmërinë e vendimit të kryeregjistruesit dhe kompetencën e këtij organi për fshirjen e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme. Në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 17/2010 në çështjen konkrete, gjykatat i janë referuar nenit 76, pika 2, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit vendimet e saj që shfuqizojnë ligje ose akte normative si të papajtueshme me Kushtetutën kanë fuqi prapavepruese ndaj çështjeve gjyqësore ende të papërfunduara. Në rastin konkret, ndonëse padia ishte paraqitur përpara dhënies së vendimit nr. 17/2010, procesi gjyqësor ishte ende në shqyrtim në kohën e hyrjes së tij në fuqi. Për rrjedhojë, gjykatat e zakonshme e kanë mbështetur zbatimin e këtij vendimi në një dispozitë të shprehur ligjore, kushtet e së cilës rezultojnë të përmbushura. Kolegji çmon se ky arsyetim nuk evidenton një interpretim haptazi të paarsyeshëm ose arbitrar të efekteve të vendimit të Gjykatës.

26. Në lidhje me pretendimin për paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor, Kolegji vëren se gjykata e apelit ka evidentuar datat e njoftimit të aktit administrativ dhe të paraqitjes së padisë, ndërsa e ka konsideruar aktin e kundërshtuar absolutisht të pavlefshëm për shkak të kapërcimit të kompetencave të kryeregjistruesit. Sipas nenit 117, pika 2, të KPA-së, i zbatueshëm në kohën e ngritjes së padisë, kërkimi për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ mund të paraqitej në çdo kohë. Në rastin konkret, gjykatat e kanë mbështetur zgjidhjen e mosmarrëveshjes në cilësimin e shkeljes së konstatuar si shkak të pavlefshmërisë absolute. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkueses për afatin e padisë, përfshirë falsifikimin e pretenduar të datës së njoftimit të vendimit të kryeregjistruesit, nuk evidentojnë një zbatim haptazi arbitrar të ligjit procedural.

27. Po ashtu, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga subjektet, regjistrimet e pasurive të të cilëve ishin fshirë me vendimin e kryeregjistruesit, çka përligjte interesin e tyre për kundërshtimin gjyqësor të këtij akti. Ndërkohë, gjykatat e zakonshme nuk kanë shqyrtuar pretendimet për vlefshmërinë e titujve të pronësisë dhe dokumentacionin e regjistrimit të pasurive, duke vlerësuar se ato nuk ishin përcaktuese për zgjidhjen e

mosmarrëveshjes mbi kompetencën e kryeregjistruesit për fshirjen e regjistrimeve. Për këtë arsye, shqyrtimi i mosmarrëveshjes nga gjykatat nuk rezulton të ketë qenë i kushtëzuar nga përfundimi i një procesi tjetër për vlefshmërinë e titujve të pronësisë, sikurse ka pretenduar kërkuesja lidhur me pezullimin e gjykimit.

28. Në lidhje me pretendimin për mosrespektimin e detyrave të lëna për rigjykim dhe ndryshimin e objektit të padisë, Kolegji vëren se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 481, datë 06.03.2012, kishte evidentuar se paditësit kishin kërkuar anulimin e vendimit të kryeregjistruesit dhe jo konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tij. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shqyrtuar shkakun e paligjshmërisë së aktit, duke vlerësuar se ai ishte nxjerrë në kapërcim të kompetencave ligjore të organit administrativ, ndërsa në dispozitiv ka vendosur pranimin e padisë dhe anulimin e tij. Për rrjedhojë, pavarësisht cilësimit juridik të shkeljes si shkak të pavlefshmërisë absolute, gjykata e rigjykimit ka disponuar për kërkimin e paraqitur nga paditësit. Në këtë aspekt, argumentet e kërkueses nuk evidentojnë një tejkalim të kufijve të gjykimit që të përbëjë cenim të garancive kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

29. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka identifikuar shkaqet e parashtruara në rekurs dhe ka arsyetuar se ato nuk përfshiheshin në rastet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Duke i vlerësuar vendimet e kundërshtuara në tërësinë e tyre, Kolegji çmon se argumentet e kërkueses nuk evidentojnë mangësi në arsyetim që ta bëjnë procesin gjyqësor haptazi të paarsyeshëm ose arbitrar. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

30. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, Kolegji vëren se vendimi nr. 485, datë 16.07.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me të cilin është vendosur kthimi në favor të trashëgimlënësit të kërkueses i sipërfaqes së truallit prej 819 m^2, ka marrë formë të prerë dhe vijon të jetë i vlefshëm. Procesi gjyqësor i kundërshtuar ka pasur për objekt kontrollin e ligjshmërisë së vendimit nr. 26/2008 të kryeregjistruesit për fshirjen e regjistrimeve të pasurive të paluajtshme në favor të personave të tretë dhe jo rishqyrtimin e së drejtës së pronësisë të njohur me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, zbatimi i vendimit nr. 17/2010 të Gjykatës nga gjykatat e zakonshme ka ndikuar në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kryeregjistruesit, por nuk ka sjellë ndryshimin ose shfuqizimin e titullit gjyqësor në favor të trashëgimlënësit të kërkueses. Megjithatë, ruajtja e fuqisë juridike të këtij titulli nuk përjashton mundësinë e pengesave për realizimin efektiv të së drejtës së njohur me të.

31. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është përqendruar në ligjshmërinë e ushtrimit të kompetencës së kryeregjistruesit dhe nuk ka pasur për objekt

zgjidhjen e mosmarrëveshjes për titujt e pronësisë ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor të vitit 1999. Vendimet e kundërshtuara nuk kanë përcaktuar përfundimisht të drejtat e pronësisë së palëve mbi sipërfaqet që, sipas vendimit administrativ të kundërshtuar gjyqësisht, mbivendoseshin. Duke mbajtur në konsideratë objektin dhe kufijtë e këtij procesi, si dhe përfundimet e mësipërme lidhur me respektimin e garancive të procesit të rregullt ligjor, Kolegji çmon se argumentet e parashtruara nga kërkuesja nuk janë të mjaftueshme për të evidentuar se mënyra e zbatimit të vendimit nr. 17/2010 nga gjykatat e zakonshme ka sjellë cenimin e së drejtës së saj të pronës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

32. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat "a" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.